



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:199534  
Datë: 08.05.2024  
Numri i dokumentit: 05665908

PML.nr.283/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Agim Maliqi kryetar kolegji, Afrim Shala dhe Valdete Daka anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit F. M., për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprat penale grabitja nga neni 317 par.3 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK, vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe veprën penale zjarrvënja nga neni 322 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurit F. M. av. Luljeta Jashari Hertica, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.9/2024 të datës 25.03.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.DKR.nr.321/2024 të datës 17.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit F. M., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR. nr.9/2024 të datës 25.03.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.DKR.nr.321/2024 të datës 17.04.2024.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin PKR. nr.9/2024 të datës 25.03.2024, të pandehurve A. S., F. M., F.1 M.1 dhe Xh. S., për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale grabitja nga neni 317 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK, secili veç e veç veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK, të pandehurit A. S. dhe F. M. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe të pandehurit A. S. dhe F. M. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje zjarrvënja nga neni 322 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK, ua ka vazhduar masën e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj, nga data 26.03.2024 deri me datën 26.05.2024, konform dispozitës së nenit 184 par. 1 nën par. par.1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).]

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN1.DKR.nr.321/2024 të datës 17.04.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve A. S., F. M., F.1 M.1 dhe Xh. S. dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësja e të pandehurit F. M. av. Luljeta Jashari Hertica, për shkak të shkeljeve të të drejtave që i njihen palës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të KPP të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar dhe aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që të pandehurit t'i ndërpritet paraburgimi apo masa e paraburgimit t'i zëvendësohet me ndonjë masë tjetër alternative më të favorshme.

Kryeprokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.122/2024 të datës 03.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësja ka theksuar se aktvendimet e kundërshtuara janë vetëm parafrazime të dispozitave ligjore dhe se u mungon arsyetimi për të gjitha faktet vendimtare për vazhdimin e paraburgimit. Nuk ka dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, dhe se arsyet për vazhdimin e paraburgimit janë të pabazuara dhe të paargumentuara dhe se mungesa e arsyetimit të një vendimi, apo parafrazimi i thjeshtë i ligjit si arsyetim, përbën shkelje esenciale të procedurës penale. Vlerësimi i rrezikut të ikjes, ndikimit në prova e dëshmitarë si dhe rreziku i përsëritjes së veprave penale duhet të bëhet nga faktorë relevantë të cilët konfirmojnë një rrezik të tillë dhe se vazhdimi i paraburgimit në praninë e masave tjera alternative është i padrejtë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga aktakuza PP.I.nr.203/2023 e datës 05.01.2024 dhe shkresave tjera në lëndë, rezultojnë dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, kurse a do të argumentohen këto fakte e prova do të vlerësohet në fazat e ardhme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par. 1 nën par. 1.1. e 1.2. të KPP.

Po ashtu, kjo Gjykatë, gjen se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1 të KPP, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale për faktin se veprat penale për të cilat akuzohet i pandehuri janë të natyrës së rëndë dhe për to parashihen dënime mjaft të larta e është e arsyeshme droja fshehjes, arratisjes apo edhe ikjes dhe në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.3 të KPP, duke pasur parasysh peshën e veprave penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale, nën kërcënim dhe kanosje me përdorimin e armës, duke ua marrë shumën e parave, janë rrethana të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsëris veprat penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pika 1.2.2 e dispozitës së nenit 184 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 të KPP, hiqet për arsye se nuk qëndron tani kjo bazë ligjore, pasi që është ngritur aktakuza dhe i pandehuri nuk mund të ketë ndikim në prova dhe dëshmi e dëshmitarë, pasi që në shkresat e lëndës ekzistojnë provat dhe deklaratat e dhëna.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale e as te ligjit penal, sepse të dy gjykatat kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i konsideron edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.283/2024 datë 08.05.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale  
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,  
Agim Maliqi